

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(II. ad Cor. III. 17).

1. Idealista pá ideal	Fq. 469
2. Programi i Kryeministrit	„ 473
3. Eneida e Vergilit	„ 476
4. Dorëshkrimet e At Gjeçovit	„ 481
5. Vjerrsha të pabotueme të t' Êmz. Pjeter Zarishit	„ 488
6. Lojë të komtare	„ 492
7. Pellasgë e Hellenë	„ 495
8. Kshtë të nderohen Fatosat e Komit X	„ 501
9. Gjurmime...	„ 511
10. Lajme rrokull Shqypnis	„ 516
11. Lajme rrokull botës	„ 518

BIBLIOTEKA KOMBËTARE  
TIRANE



---

---

*Drejtimi man tagrin më çdo artikull, që botohet në këtë  
Perkohshme, tue ndaluar njëherit edhe çdo rishtypje a perkthim.*

---

---



## Idealista pá ideal

Qe se i a mrríjtem edhe ksajë: Politika shtíni nder gjire të veta — po thuej — të gjitha lamijet e jetës nierzore. Sod nuk kemi vetem politikë shtetnore e kombtare; politika ka depertue në jeten shoqnore, ekonomike etj. etj. hîni dér në kulturë e mâtet t' a bâjë per veti edhe jeten morale.

Shka don me thanë politikë? Shfrytsim i rasës, i ndolljes, i çasit. Kshtû nemose tash së voni shkruete, e, — me shumicen e shkrintarve t' onë — kuptote nji shqyptár në shêj per idealogí nierzore e atdhetare. Ksajë sod i thonë politikë reale.

Ktij parimi e ktij sistemi na shqyp i thomi *me e qitë ujin në mullí të vet*, me çë do mndyrë e me çë do mjet, pá marrë para sýsh as parim as drejtsí, por vetem e vetem si t'a levertisë e si të del mâ mirë per veti a per çashtje qi ké marrë mbí veti.

Në ket mndyrë politika bâhet nji i ë avokature, por me ket ndryshim, se prej avokati kerkohet ligjë e drejtsí, me sá nieri i politikës, në themel të ktij parimi, po desht verte të bâjë politikë, e xên vetin të liruem prej çë farë do ligje, edhe të nderës e të moralit. *Suprema lex* e tija ásht dobija reale e konkrete qi do të xjerrë.

Kallzojn per Knjaz Nikollen e Malit Zí, se tue ndëjë 'i qitë me nji mik të vetin, paska rá bisedimi mbí politikë.

Shka ásht politika? — e pvetka miku Knjazin.

Tue pasë ngurrue aj në të pergjegjun, më lën, t'a kallzoj, Madhní, i thánka miku: Politikë don me thanë, po të rrêjsh

